



ROMANIA
Ministry of Foreign Affairs



COUNCIL OF EUROPE
CONSEIL DE L'EUROPE

Unofficial translation

TRYEZË E RRUMBULLAKËT

KTHIMI/KOMPENSIMI I PRONAVE: MASA TË PËRGJITHSHME NË PËRSHTATJE ME VENDIMET E GJYKATËS EVROPIANE

Organizuar me mbështetjen financiare të ‘Human Rights Trust Fund’ në kuadër të projektit “Eliminimi i pengesave për zbatimin e vendimeve gjyqësore vendase/Sigurimi i zbatimit efektiv të vendimeve gjyqësore vendase”

Bukuresht, Howard Johnson Hotel,
5-7 Calea Dorobantilor Dist. 1, Bukuresht, 010551 Rumani

INFORMACION

Informacion i përgjithshëm

Ne fillimet e viteve 1990, kthimi dhe kompensimi i pronave të marra nga regjimet komuniste, ka qënë një çështje shqetësuese për vendet e Evropës Qendrore e Lindore.

Me vendosjen e demokracisë, shume nga këto Shtete, zgjodhën të marrin masa në favor të ish pronarëve, qoftë në kuptimin e kthimit të pronës, apo kompensimit të saj. Qëllimi dhe rregullimi i këtyre masave, ndryshonte dhe ka patur ndryshime domethënëse ne formën e kompensimit, adoptuar nga Shtetet.

Shtetet kanë të drejtën e një diskrecioni absolut për të vendosur qëllimin e kthimit të pronës dhe kushtet në të cilat do të behet kthimi apo kompensimi i pronës së humbur. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (“Gjykata Evropiane”) ka përcaktuar në këtë kuadër se Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore “Konventa”, nuk ka vendosur asnjë detyrim për kthimin e pronës që i ka kaluar shtetit, përpara ratifikimit të Konventës. Megjithatë, Shtetet Kontraktuese që kanë vendosur të procedojnë me procesin e kthimit pas ratifikimit, kanë detyrimin që këtë proces, ta kryejnë në përputhje me kërkesat e konventës.

Vështirësitë e trashëguara nga një process kaq i gjerë, kanë gjeneruar një ngarekesë të rëndësishme përpara Gjykatës Evropiane. Numri në rritje i vendimeve kundër Shteteve Kontraktuese, që nxjerrin në pah mungesa të ndryshme në mekanizmin e kthimit dhe kompensimit të pronës, përbën sfida të reja për Komitetin e Ministrave të Keshillit të Evropës, të cilit Konventa i ka besuar mbikqyrjen e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane.

Duke iu rikthyer eksperiencës Rumune, që prej vitit 2004, Gjykata Evropiane, ka dhënë afërsisht 240 vendime në lidhje me kthimin/kompensimin e pronës. Ekzektuimi i tyre, është mbikqyrur nga Komiteti i Ministrave në kuadër të çështjeve *Străin dhe të tjerët dhe Sabin Popescu*. Në të gjithë këto çështje, Gjykata Evropiane ka identifikuar mosfunksionimin e mekanizmit të kthimit/kompensimit të pronës. Në gjykime të mëvonshme, ky mosfunksionim, u kualifikua si “sistemik” i cili u konstatua se krijon një problem të përsëritur në Rumani, pamvarësisht hapave të

marra nga autoritetet Rumune në përshtatje të vendimeve të tjera të Gjykatës. Rreth 2,000 çështje të ngjashme, janë aktualisht në pritje përpara Gjykatës.

Në këto kushte, Gjykata Evropiane ka aplikuar së fundmi procedurën e gjykimit pilot për çështjen *Maria Atanasiu dhe të tjerët k. Rumanisë* (Vendim datë 12/10/2010, i formës së prerë më 12/01/2011). Duke njohur kompleksitetin e çështjeve me të cilat janë përballur autoritetet Rumune, Gjykata Evropiane konsideroi se ato duhet të venë në jetë masa të afta të japin zgjidhje të përshtatshme për të gjithë ata që preken nga ligjet e kthimit të pronës, brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit (p.sh.12 Korrik 2012). I takon tashmë autoriteteve Rumune, nën mbikqyrjen e Komitetit të Ministrave, të venë në zbatim masa të përshtatshme, duke patur parasysh se disa nga këto masa janë identifikuar tashmë në një plan veprimi të paraqitur përpara Komitetit të Ministrave në Shkurt 2010.

Përveç vendimeve kundër Rumanisë, Gjykata Evropiane ka dhënë gjithashtu disa vendime kundër Shqipërisë, lidhur me dështimin për të zbatuar vendime gjyqësore të formës së prerë, dhe vendime administrative që njohin të drejtën e aplikantit për kthimin apo kompensimin e pronës. Në çështjet si *Driza dhe Ramadhi*, Gjykata Evropiane ka theksuar se autoritetet Shqiptare duhet ndër të tjera: të përcaktojnë një organ kompetent; të përcaktojnë rregullat procedurale; të sigurojnë përputhshmërinë me këto rregulla në praktikë; dhe të eliminojnë të gjithë pengesat lidhur me dhënien e kompensimit në bazë të Ligjit të Pronës, duke adoptuar masa përkatëse legjislative, si dhe administrative e buxhetore. Këto masa duhet të përfshijnë hartat për vlerësimin e tokës dhe përcaktimin e fondeve përkatëse. Ekzekutimi i vendimeve do të mbikqyret nga Komiteti i Ministrave në kuadër të grupit të çështjeve *Driza*.

Tryeza e Rrumbullakët : sesionet plenare e tematike

Kjo tryezë e rrumbullakët, sunon të krijojë një forum për shkëmbimin e eksperiencës së Shteteve pjesëmarrëse, në çështjen e kthimit/kompensimit të pronave dhe kapërcimin e sfidave lidhur me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane. Midis Shteteve pjesëmarrëse, disa prej tyre e kanë përfunduar me sukses procesin e kthimit/kompensimit të pronës, për disa të tjerë ky proces është në vijim, ndërsa në disa të tjerë, legjislacioni për kthimin/kompensimin, nuk është miratuar ende. Eksperiencat e kaluara dhe aktuale të disa shteteve, mund të shërbejnë edhe për shtetet e tjera.

Gjatë sesionit të paradites, pjesëmarrës të nivelit të lartë, do të shkëmbejnë eksperiencat e tyre lidhur me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave në vendet përkatëse. Shpresojmë se nga këto prezantime do të dalin shembuj të praktikave më të mira. Sesioni i pasdites, do të përbëhet nga dy sesione të ndryshëm që do të fokusohen në sfidat kryesore që janë hasur deri tani në procesin e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane.

Gjatë sesionit të parë, prezantimet dhe diskutimet do të përqendrohen në praktikat më të mira dhe vështirësitë e hasura në procesin e hartimit të legjislacionit lidhur me kthimin/kompensimin e pronës.

Gjatë sesionit të dytë prezantimet dhe diskutimet do të përqendrohen në praktikat më të mira dhe vështirësitë e hasura në venien në zbatim të legjislacionit përkatës.

Në fund të sesioneve, pjesëmarrësit do të mblidhen në sesion plenar, për të adoptuar konkluzionet e tryezës, bazuar në përmbledhjen e diskutimeve të mëparëshme.
